



## KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I.Numër:400/04-8772, dt. 26. Shkurt 2026.

Në bazë të nenit 11 e nenit 12.2 pika d) dhe nenit 25 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28.datë: 04.qershor 2008”), nenit 5. paragrafi 2. të Ligjit për Ndërmarrjet Publike të Republikës së Kosovës Nr.03/L – 087 datë: 13 qershor 2008, nenit 20, paragrafi 1 pika 1.4. të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I.Numër:01-016/01-413431 dt. 30. Shtator 2020, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 26 Shkurt 2026, merr këtë:

### VENDIM

Nr.07/2026

#### mbi themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të N.P.L.”EKO - SIG” SH.A. PEJË

- Emërohet Komisioni Komunal i Aksionarëve për ushtrimin e të drejtës aksionare të Komunës së Pejës, në N.P.L. “EKO - SIG” sh.a. me seli në Pejë, në përbërje:
  - 1.1. Agron Nikqi, drejtor DPKSHP. anëtarë i emëruar nga Kryetari i Komunës.
  - 1.2. Kaltrina Lajqi, anëtarë i Kuvendit Komunal nga subjekti politikë LDK, dhe
  - 1.3. Arta Nallbani, anëtarë i kuvendit komunal nga subjekti politikë PDK.
- Komisioni nga pika 1 e këtij Vendimi do të ushtrojë të drejtën e Komunës së Pejës, si aksionare në N.P.L. “EKO-SIG” sh.a. me seli në Pejë, konform nenit 5. paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike, si dhe duhet të veproi në përputhje me Ligjin Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare.
- Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Pejës.
- Me këtë Vendim shfuqizohet Vendimi Numër: 112-02/4529, dt.31 Janar 2023, mbi themelimin e KKA të N.P.L. “EKO - SIG” sh.a. me seli në Pejë.
- Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës së Pejës.

#### Vendimi i dërgohet:

MAPL,  
Kryetarit të Komunës,  
DPKSHP dhe anëtareve të zgjedhur,  
Arkivë.



KRYESUESI I KUVENDIT,  
Rexhep Kurtbogaj